

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË "MARIN COMPANY" SH.P.K)

E hartuar ne Lushnje sot më datë 11.01.2021 nga palet:

SHITES: **Dritan Çuko**, atësia Laze, amësia Jorgjie, shtetase Shqiptare, lindur me 24.02.1977 në Lushnje dhe banues në Lushnje, me identitetin sipas Leternjoftim nr. 027328399 dhe nr. personal H70924090R, ortak i shoqerise "MARIN COMPANY" SHPK me nipt L84814401P .

BLERES: **Suada Velo**, shtetase shqiptare, lindur me 02.04.1987 në Lushnje dhe banues në Lushnje, mbajtese e kartes se identitetit me numer leternjoftimi 024775421 dhe me numer personal I75402128Q e cila eshte ortake ne Shoqerine "MARIN COMPANY" SHPK.

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord te hartojne Kontratën e Shitjes te 50 % të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "MARIN COMPANY" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Per kete akt shitblerje eshte mare vendim te Asamblese nr 1 date 11.01.2021 per kalimin e pronesise se 50% te kuotave te kapitalit si me poshte :

-Palet te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe bazuar ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 ndryshuar me Ligjin nr 10475 date 27.10.2011 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", neneve 705 -750 te Kodit Civil, kerkuan te lidhin e redaktojne kontrate shitje kuotave te kapitalit dhe transferimit te kuotave kapitalit shoqerise si me poshte.

-**Pala shitese** Dritan Çuko, deklarone se 50% te kuotave te kapitalit te stij ,ne Shoqerine "MARIN COMPANY " , t'ja shesi sot me date 11.01.2021 ne vleren 300.000 (treqindmije) leke ,blereses Suada Velo, e cila eshte plotesisht dakort dhe e blen me kushtet e vleresimit me mirekuptim mes vete paleve si me siper .

- **Pala blerese** Suada Velo, deklarone se i blen 50% kuota kapitali nga pala shitese me vleren e shitjes qe eshte 300.000 (treqindmije) leke .


Pala shitese zhvishet nga te gjitha te drejtat dhe detyrimet ne lidhje me pjesen prej 50% kuota kapitali te cilat i kalojne blesesit .Pala blerese mer persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet ne lidhje me kete shoqeri dhe behet pronar i 100% te kuotave te kapitalit ne shoqerine " MARINI CO " SHPK .

Gjithashtu ,pas ketij veprimi lind e drejta ,per tu bere regjistrimet , konforme procedurave ligjore dhe kushteve te percaktuara ne kete kontrate . Palet nuk kane asnje pretendim te metejshem .

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

Dritan Çuko



BLERES

Suada Velo

